

Oda e Stomatologeve te Kosovës (OSK)

Raport i auditimi funksional i Organeve të OSK-së

/për Pasqyrat Financiare 2021/

Bazuar ne Specifikimet teknike të paraqitura ne dosjen e tenderit se OSKsë përveq dhenies së Opinionit për Pasqyrat fianciare 2021 të Odës së Stomatologeve të Kosovës (OSK) konform Standardeve Nderkombetare të Auditimit (SNA) , kemi marrë përgjegjësinë të kryejmë auditimin funksional të Organeve të OSK-së e cila njeherit është pjesë përberëse e Raportit të Auditorit .

Ne këtë Raport do të prezentojm performancën dhe gjetjet eventuale të cilat nuk vlersohen si materiale por me shumë janë si mosrespektim i parimeve dhe rregolloreve ne disa raste

Ne vijim ju prezentojmë gjetjet lidhur pasqyart financiare 2021 si dhe vlersimet tona lidhur me punen e organeve të OSK-së për këtë periudhë.

Raporti auditimit funksional (performancës) të organeve të OSK-së per vitin 2021

Sipas kërkeses së Odës dhe duke u bazuar ne Ligjin Nr.04/L-150 për Odat Profesionale Shëndetësore , Statutin e OSK-sq ne kemi marrë persipër që të auditojmë performancën e organeve të OSK-së për periudhën 2021.

Konform nenit 18 të Statuti të OSK -së , Oda ka të themeluar keto organe :

- ❖ Kuvendin ,
- ❖ Kryetari Odes ,
- ❖ Keshilli Drejtues ,
- ❖ Keshilli mbikqyres,
- ❖ Keshilli Etik, Gjyqi i nderit, Prokurori i Odës dhe
- ❖ Komisionet e përhershme

Mbeshtetur ne nenin 47 të Statutit Oda ka për obligim transparencën dhe raportimin për punën e Organeve dhe Komisioneve të përhershme të OSK-së.

Bazuar ne Raportin vjetor prill 2021 – Mars 2022 të Odës pamë se janë kryer shumë aktivitete konformë përgjegjësiave dhe kompetencave të cilat kishim i veçuar si me poshtë :

- Rritja e transparencës përmes publikimit dhe informimit ne Web-faqës së OSK-së për aktivitetet e ndodhura gjatë kësaj periudhe.
- Azhurnimi i regjistrimit të anetarësisë dhe regjistrimit të Licencave ne baza mujore .
- Organizimi i Edukimit të vazhduhem profesional për antarët e OSK-së
- Organizimi i Konferencës stomatologjike .
- Shqyrtimi i rasteve të shkeljeve etike .
- Monitorimi dhe menaxhimi i financave dhe buxhetit.
- Bashkëpunimi nderkombetarë lidhur me aktivitetet stomatologjike.

Gjatë verifikimit të deshmive lidhur me zbatueshmërisë së akteve normative per vitin 2021 nga ana e organeve të OSK-së ne mund të konstatojmë me sa vijon :

1. Për Kuvendin si organi me i lartë i OSK-së gjatë auditimit pamë se janë zbatuar kompetencat e tij qe dalin nga nenit 20 i Statutit të OSK-së, duke potencuar fillimisht me zgjedhjen e të gjitha Organeve të OSK-së ne mbledhjet e mbajtur me 5 Maj 2021 ku është miratuar raporti vjetor i punës së OSK-së dhe 30 Tetor 2021 ku janë miratuar disa ndryshime ne Rregullore , taksa administrative dhe disa anëtarë të komisioneve të OSK-së
2. Kryetari i OSK-së bazuar ne verifikimet tona vlersojmë se pergjegjësitë qe dalin nga neni 23 i Statutit të OSK-së dhe neni 9 i Rregullores per procedura vendimarrëse të OSK-së janë kryer me kompetencë dhe profesionalizem.
3. Këshilli Drejtues (KD) , Bazuar ne procesverbalet e KD konstatoam se KD gjatë kësaj periudhes ka mbajtur 8 takime ku janë marrë vendime të rëndësishme si ; ndërrimi i lokacionit të selisë se OSK-së , draftimi i disa rregulloreve që lidhen me punen e Odës , vendime per ceshtje financiare , miratimi i raportve vjetore të punës së organeve , emertimi Këshillit të Ekspertëve Profesional të OSK-së etj.projekt buxheti per vitin 2022 etj.
Nga mostrat e perzgjedhuara për verifikim të aktiviteteve për KD si organ kyq i Odës nuk kemi gjetur ndonje parregullsi për pune e tij gjatë kësaj periudhe.
4. Këshilli Mbikqyrës , bazuar ne Raportin vjetor nuk pamë informacione lidhur me aktivitetet e realizuara gjatë kësaj periudhe ashtu siç kërkohen me nenit 29 pika 1.1 mbikqyrja e afarizmit financiar të odës , deri sa nuk vërehet raste për ndonje shkelje të drejtave të antarëve të odës.
5. Këshilli Etik , Gjyqi i Nderit dhe Prokurori i Odës si organe të mbrojtës së profesionit dhe vet komunitetit , bazuar ne raportet e Komisionit për çeshtje etike dhe deshmitë tjera të verifikuara e vlerësojmë se ne përgjithësi janë zbatuar kompetencat qe dalin nga nenet 31 , 34 dhe 35 të Statutit të Osk-së , ku gjatë periudhe nga Komisioni për çeshtje etike janë shqyrtuara 8 ratse.
6. Komisionet e përhershme , bazuar në nenin 37 të OSK-së od aka të themeluar 6 Komisione të përhershme dhe fushveprimtaria e tyre është e percaktuar me Rregullore të mbrendshme të miratuara nga Kuvendi Odës.

Gjatë verifikimit të deshmive me qëllim të vlersimit të performances së organeve të odës me shumë jemi fokusuar ne punen e komisionit për Licencim dhe komisionit për buxhet dhe financa.

- Lidhur me punen e Komisionit për Licencim gjatë kësaj periudhe janë antërsuar rreth 300 stomatolog , janë Licencuar mbi 300 po aq edhe janë rilicencuar.
Nga mostrat e perzgedhura për verifikim të ratseve për licencim dhe ri-licencim të anëtarve konstuam se komisioni ka respektuar aktet normative të përcaktuara ne rregulloren për Licencim të profesionisteve shendetësor.
 - Komisioni per Eddukim të Vazhdueshem profesional (EVP) për këtë periudhe bazuar ne raportet e tij ka mbajtur 5 kofnerenca, 2 seminare , 17 ligjerata 6 kurse etje.
Ne kemi verifikuar si mostra disa aktiviteteve te cekuar dhe bazuar ne deshmit e perzgjdhuara konstatuam keto aktivitete janë organizuar konformë Rregulloreve te OSK-së.
 - Komisioni për çeshtje Etike gjatë kësaj periudhe janë shqyrtuar 8 ratse për shkelje etike , 9 raste për leje hulumtimi bio-mjeksor etj.
 - Komisioni për buxhet dhe financa per vitin 2021 ka shqyrtuar dhe aprovuar raportet financiare dhe projektine e buxhetit të OSK-së për vitin 2022.
Departamenti i financave dhe kontabilitetit të OSK-së ka mirëmbajtur dhe avansuar evidencat kontabël duke kompletuar listen e anëtarve të OSK-së si bazë për të hyart e Odës duke finalizuar me Pasqyrat vjetore financiare Janar-Dhjetor 2021.Bazuar
Krahasuar poazicionet e Pasqyrave financiare e vitit 2021 ne raport me ato të vitit paraprak të hyrat janë rritur gati për 3 herë ma shumë , deri sa ne vitin 2020 ardhurat ishin rreth 77 mijë euro ne vitin 2021 ka rezultuar me mbi 200 mijë euro duke krijuar një gjendje stabile financiare.
Bazuar ne mostrat e perzgjedhura për verifikim konstatojmë se shpenzimet e buxhetit janë ekzekutuar ne harmoni me Rregulloren e OSK-së per menaxhimin e financave duke zbatuar procedurat e prokurimit publik për shumat mbi limitin e caktuar sipas nenit 4 pika 2 e Rregullorës Nr.1060.
 - Edhe Komisioni për solidaritet ka shqyrtuar dhe aporvuar rastet për mbeshtetje financiare.
7. Oda e Sotmatologeve të Kosovës gjatë kësaj perudhe ka zhvilluar aktivitete të rendësishme ne bashkëpunimin ndërkombëtar dhe vendor qe lidhen me profesionin e stomatologjisë

Letrën e punuan auditoret ligjor :

Haxhi Nimanaj dhe Nijazi Jakupi



Gusht 2022



Oda e Stomatologëve të Kosovës

Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

DATA/DATUM/DATE:	12.09.2022.
PËR/ZA/TO:	Prof. Dr. Blerim Kamberi, Kryetar në OSK
CC:	Haxhi Nimanaj, Auditor i Jashtëm "AuditCheck" shpk
NGA/OD/FROM:	Agron Kabashi, Zyrtar i Financave në OSK <i>Agron Kabashi</i>
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Njoftim për draft raportet e auditimit financiar dhe funksional të OSK-së për vitin 2021.

I nderuar Kryetar,

Përmes kësaj shkrese ju njoftoj rreth procesit të auditimit financiar dhe funksional të OSK-së për vitin financiar 2021, të kryer nga kompania audituese "Auditcheck" shpk.

Me datë **05.09.2022** dhe **09.09.2022**, përmes e-mailit zyrtar të OSK-së ne kemi pranuar draft raportet e auditimit financiar dhe funksional të OSK-së, raporte të përpiluara nga kompania audituese "Auditcheck". Me këtë nga auditori i jashtëm është kërkuar që të japim komentet apo sygjerimet tona lidhur me draft raportet e lartëcekura.

- Draft Raportet:

1. Auditimi Financiar i OSK për vitin 2021, dhe
2. Auditimi Funksional i OSK-së për vitin 2021

Auditori i jashtëm "Audit Check" shpk - zt. Haxhi Nimanaj.

- Komentet e OSK-së,

Me rastin e pranimit të draft raporteve nga auditori i jashtëm, nga ana jonë është kërkuar që të japim komentet apo sygjërimet tona për raportet e pranuar.

- 1- Pas shiqimit të draft raportit financiar të auditorit të jashtëm të OSK-së për vitin 2021, ne konstatojmë që të dhënat e prezantuara në pasqyrat financiare paraqesin të dhëna të drejta dhe të sakta lidhur me pozicionin financiar dhe pasqyrën e të ardhurave të OSK-së për vitin financiar 2021.
- 2- Poashtu, pas shiqimit të draft raportit të auditimit funksional të organeve të OSK-së për vitin 2021, ne konstatojmë që komentet e dhëna nga auditori i jashtëm janë të qëndrueshme dhe të pranueshme nga ana jonë.

Prandaj, bazuar në faktet e lartëcekura në pikat 1 dhe 2, nga OSK nuk kemi ndonjë koment apo sygjërim shtesë lidhur me raportet e pranuar nga auditori i jashtëm “Audit Check” shpk - zt. Haxhi Ninamaj.